



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PUKË**  
**Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike -**  
**Zyra e Prokurimeve Publike**

*Nr. 558/12Prot*

*Date 06.05.2021*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Nga: **Bashkia Puke**, Sheshi Gjergj Kastriot Skenderbeu, Nr.1, Puke

Për: “ **JUBICA** ”sh.p.k Shkoder,SHKODER rruga Luigj Gurakuqi ,Kuklejt nr.108 Perfaqesues z.Ndoc Kulla

Procedura e prokurimit: Tender I hapur

Numri i references se procedures/lotit : **REF-89005-03-04-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Ujesjellesi i fshatit Luf-Bashkia Puke**”

Kohezgjatja e kontrates 6 muaj

Fondi Limit 81,246,308 (Tetedhjetenje milion e dyqinde e dyzet e gjashtemije e treqinde e tete) leke pa tvsh

Burimi i financimit : vene ne dispozicion nga Agjencia Kombetare e Ujesjelles Kanalizimeve, financiar ne 4 vite kalendarike 2021,2022,2023 dhe 2024 (vlere e financimit per vitin 2021 eshte 19,560,000 leke per 2022 eshte 9,780,000 leke ,per vitin 2023 eshte 9,780,000 leke pjesa tjetere 2024

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [08.03.2021] [34]

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 12.04.2021, ora 10.00.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët**  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qene pjesëmarrës në procedurë 5 ofertues me vleren përkatëse të ofruara:

1. B.O Ekonomik “**KAEXH**”sh.p.k & “**ULZA**”sh.p.k numri i NIPT-it  
K71420004C & J67902928O

Formularin e ofertes, me vlere **72,118,894** (Shtatedhjetete e dymilion e teteqinde e njeqinde e tetembedhjetemije e teteqinde e nentedhjetete e kater ) leke pa tvsh, si dhe dokumentat ngarkuar ne sistem.

2. Operatori Ekonomik “**JUBICA**”sh.p.k numri i NIPT-it K26529001I

Formularin e ofertes, me vlere **80,000,025** (Tetedhjetemilion e njezet e pese ) leke pa tvsh, si dhe dokumentat ngarkuar ne sistem.

3. Operatori Ekonomik “**STERKAJ**”sh.p.k numri i NIPT-it J68310708M

Formularin e ofertes, me vlere **80,143,357** (Tetedhjetemilion e njeqinde e dyzet e tremije e treqinde e pesedhjetete e shtate) leke pa tvsh, si dhe dokumentat ngarkuar ne sistem.

4. Operatori Ekonomik“**ALMO KONSTRUKSION**”sh.p.k numri i NIPT-it J91915001P

Formularin e ofertes, me vlere **80,433,458** (Tetedhjetemilion e katerqinde e tridhjetete e tremije e katerqinde e pesedhjetete e tete) leke pa tvsh, si dhe dokumentat ngarkuar ne sistem.

5.Operatori Ekonomik **“METEO”sh.p.k** numri i NIPT-it L26310801C

Formularin e ofertes, me vlere **80,670,651.6** ( Tetedhjetemilion e gjashteqinde e shtatedhjetemije e gjashteqinde e pesedhjetete e nje pike gjashte)leke pa tvsh, si dhe dokumentat ngarkuar ne sistem.

Nga kontrolli dokumentave te paraqitura nga operatori ekonomik per plotesimin e kerkesave per kualifikim ligjore dhe kerkesave te vecanta teknike sipas dokumentave standarte te tenderit rezultonte se:

Kualifikohen op,ekonomik :

1. **Op.ekonomik “JUBICA”sh.p.k** me oferte, me vlere **80,000,025** (Tetedhjetemilion e njezet e pese ) leke pa tvsh,shpallet fitues si oferte me vlere me te vogel.
2. **Op.ekonomik “STERKAJ”sh.p.k** me oferte, me vlere **80,143,357** (Tetedhjetemilion e neqinde e dyzet e tremije e treqinde e pesedhjetete e shtate) leke pa tvsh

**Skualifikohen op.ekonomik :**

B.O Ekonomik **“KAEXH”sh.p.k & “ULZA”sh.p.k nuk kualifikohet per arsyet e meposhtme:**

*I. Ne piken 2.3.10 te kriterave te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; ... 2.3.8 Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme.*

Per te plotesuar kete kriter nga BOE Ulza shpk & K.A.E.XH shpk, jane dorezuar licensat perkatese te shoqerive. Nga kontrolli i tyre repektivisht rezulton qe:

Operatori Ulza shpk, pjese e ketij bashkimi, midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise:

- *Etleva Demiri, drejtues teknik i shoqerise, si Inxhinier mjedisi, subjekt i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Enti Rregullator i Ujit dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura shpk, si Pergjegjes Sektori.*

Operatori K.A.E.XH shpk, pjese e ketij bashkimi, midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise:

- *Dëfrim Cani, drejtues teknik i shoqerise si Inxhinier mekanik, subjekt i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Shkolles se Mesme Profesionale, Kamez, ne profilin «Mësues», po keshu ky subjket rezulton te jete e i puensuar edhe Instituti Dekliada – Alb shpk, si inxhinier mekanik, si dhe Autoshkolla «Eri», si instruktor shkolle.*
- *Skender Bejko, drejtues teknik i shoqerise si Inxhinier restaurues, subjekt i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Subjektit Ulza shpk, ne profilin «Drejtues të makinave të rënda»,*

Në kreun III "Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet", pika 2 dhe pika 3 gërma "a", paragrafi 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 "parashikohet se: 2. *Elementet e licencës: a) Licenca përmban këto elemente: I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2); II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4); III.Numrin e identifikimit; IV.Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni); V. **Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë**; VI. Selinë; VII. Afatin e vlefshmërisë; VIII.Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit; IX.Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje).*" [...]

Në kreun I "Qëllimi, fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime" pika 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 "parashikohet se:

“Drejtues teknik”- individi/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Kreu III, pika 3/c, ku thuhet c) *Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencura jo më vonë se **10 ditë** kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë.*

*Si rregull përgjegjësitë e drejtuesit teknik të shoqërisë për këtë periudhë (nga kontraktimi deri në shqyrtimin e kërkesës) mbulohen nga drejtuesi i ri i kontraktuar deri në vendimmarrjen e komisionit. Kur komisioni vendos mospranim të kërkesës ose në mungesë të dokumentacionit të plotë sekretariati teknik dërgon njoftim për plotësim dokumentacioni, sipas paragrafit VI, shkronja “a”, pika 4 e kreut II të kësaj rregulloreje, shoqëria detyrohet të pezullojë punimet menjëherë deri në licencimin sipas rregullave dhe procedurave të caktuara në këtë rregullore. [...]*

Kreu IV, “**Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë**” pika 2, percakton: *Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrie tjetër publike.*

*Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit. [...]*

Ne vijim kreu VII percakton se 1/a“ *Heqja e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim, për periudha të ndryshme të shoqërive apo kategori të drejtuesve teknikë të shoqërive, në rastet kur: I. Konstatohen ose provohen **deklarime (sipas parashikimeve në këtë rregullore) të rreme**, dokumente të pavërteta të subjektit deklarues. Në këtë rast komisioni heq licencën për një periudhë 5 vjet. II. Shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore. Në këtë rast komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.*

Licencat e paraqitur nga keta te dy operatore, pjese e bashkimt te perkohshem te OE iane te pavlefshme dhe nuk përmbushin detyrimet ligjore të parashikuara nga akti normativ në zbatim të ligjit, VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, per shkak te punesimit te drejtuesve teknike ne punemarrje publike ose shoqeri te tjerandertimi.

Referuar pikës 5 gjermës (a) dhe (b) të Kreut II të VKM nr 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, është detyrim ligjor i çdo **subjekt të licencuar** në zbatim që të aplikojë për përditësimin e të dhënave.

II. Sipas kontrates se bashkepunimit te paraqitur nga BOE Ulza shpk & K.A.E.XH shpk, rezulton qe subjekti Ulza shpk ka marre persiper te kryej 31.45 % te punimeve dhe K.A.E.XH shpk – 68.55%. Ne nenin 74, pika 1 dhe 2 të, VKM-se, 914/2014, parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të

*përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....* 2. *Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Ne kundërshtim me kete percaktim, ne kontraten e bashkepunimit nuk janë percaktuar elementet konkrete që do të kryhen nga secili operator pjesë e këtij bashkimi.* Bazuar në te, nga BOE Ulza shpk & K.A.E.XH shpk, rezulton që subjekti K.A.E.XH shpk ka marrë persiper të kryej 68.55% të punimeve, sipas projektit dhe preventivit të dhënë në tender, përjashtuar zërat e punimeve që do të kryej Ulza shpk.

III. Operatori K.A.E.XH shpk edhe pse ka marrë persiper të kryej 68.55% të punimeve nuk disponon kategorite e kerkuara të licences të cilat përmbajne punime të marra perisper:

- *N.P – 12/B Punime të inxhinierise se mjedisit.*
- *N.S – 16/A Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij*
- *N.S – 18/A Punimetopogjeodezike*
- *N.S – 20/A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë:*

Po kështu, ky operator ekonomik, pjesë e këtij bashkimi nuk plotëson as kriterin e percaktuar në pikën 2.3.3, pasi nuk ka si drejtues teknik të pakten: *inxhinier gjeodet; inxhinier mekanik; inxhinier elektrik; inxhinier mjedisi dhe inxhinier gjeolog.*

E gjitha kjo bie në kundërshtim me nenin 74, pika 3 të, VKM-se, 914/2014, ku parashikohet se:

*3.Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.*

IV. Operatori K.A.E.XH shpk ka marrë persiper të kryej 68.55% të punimeve, duhet të plotësojë i vetëm kriterin 2.3.1, a. *Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga anëtarët i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Në kontratat e paraqitura si pune të ngjashme, me subjektin privat “Teknova” me objekt Hec Lashkiza 1.2”, rezulton që fatura e vetme tatimore, brenda tri viteve nga data e zhvillimit të procedurës, nuk plotëson kriterin e dhënë me sipër. Përkundrazi kontrata me objekt “Optimizimi I rrjetit të ujesjellesit Puke” me vlerë 77.229.298 leke pa TVSH, ky operator është pjesë e JV me Almo konstruksion shpk, në masën 50.44% dhe 49.56%, rezulton në vlerën 38.895.446, leke, pra me e vogël se 50% e 81.246.308 leke = 40.623.154 leke.

V. Operatori Ulza shpk, pjesë e këtij bashkimi për të plotësuar kapacitetet teknike për mjetin «autobot uji», ka paraqitur mjetin me targa AA580MF. Në kundërshtim me deklarinimin e dhënë nga ky operator rezulton që ky mjet nuk është autobot uji, por autobot për karburant, kjo referuar kodit të paraqitur 30.1202, si dhe percaktimit në aktin e pronësive të cisternes C1.

Në dokumentet e tenderit, “Kërkesat e vecanta për kualifikim” është percaktuar: *Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim*

Neni 45, pika e, i ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” percakton ”Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë” e) **është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t’i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.** Ndersa neni 47, percakton: *Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës. Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.*

VI. Nga ky bashkim operatorësh ekonomik nuk janë plotësuar kapacitetet teknike per kapacitetin «sistem wellpoint/ekuivalent per heqje ujrash, copë, 1, në pronësi ose me qera». Nga ana e tyre është paraqitur nje pompe e thjeshte qe nuk ploteson asnje kriter minimal ne lidhje me kriterin e dhene ne dokumentet e tenderit.

Operatori Ulza shpk, pjese e ketij bashkimi per te plotësuar kapacitetet teknike per mjetin «Makine vijezi termoplastik (APV), Copë, 1, Në pronësi ose me qera», ka paraqitur nje maineri te thjeshte vijezi me boje akrilike/bikomponente, **ne kundërshtim me kriterin e dhene.** Po keshtu, nuk ka paraqitu si mjet që shënohen në regjistra publikë dokumentacionin e kerkuar ne DST: **çertifikaten e pronesise; leja e qarkullimit me percaktimin APV; certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; certifikate e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese;**

VII. Nga ky bashkim operatorësh ekonomik nuk janë plotësuar kapacitetet teknike per kapacitetin «Fabrikë Asfaltobeton, e pajisur me QKL, leje mjedisore (me largesi jo me shume se 70 Km), copë, 1, në pronësi / me qera / kontrate furnizimi». **Ne te dyja kontratat e paraqitura, rezulton qe keto kapacitete gjenden perkatesisht ne Lushnje dhe Korce, te dyja ne distance me te madhe se 70 km nga objekti.** Lidhur me deklarimin e se keto fabrika jane mobile, KVO gjykon qe eshte e pavlefshme pasi nuk permbushen dykushte thelbesore:

Rregullat e prokurimit publik kerkojne qe keto kriteret te plotësohen ne mometin e zhvillimit te pcedures, qe rezulton qe nuk jane plotësuar dhe jo ne te ardhmen dhe se dyti fabrika mobile kudo qe do te vendoset kerkon nje leje mjedisore, qe ne kete rast nuk e disponon ne distancen e barabarte ose me te vogel se 70 km nga objekti. (Kontrata e furnizimit me asfalto beton, e deklaruar nga Uleza Ndertim, mes GPG dhe Uleza Ndertim eshte me adrese ne Lushnje dhe Uleza ka bere nje vetedeklarate qe eshte nje nyje e levizshme, por Licensa III.1.B eshte leshuar per adresen Lushnje Kontrata e furnizimit me asfalto beton, e deklaruar nga KAEXH, mes KAEXH dhe 2T eshte me adrese ne Pogradec dhe ne faturen qe 2T ka per pronesine e nyjes thuhet qe eshte nyje e levizshme, por Licensa III.1.B eshte leshuar per adresen Pogradec).

VIII. Po keshtu, te gjitha mjetet e paraqitura nga Ulza shpk, sipas kontratave te qerasa jane pa emertim objekti duke mos i dhene garancine AK-se qe keto kapacitete jane te zena ne kontrata te tjera.

IX. Deklarata e Operatorit K.A.E.XH shpk, ne lidhje me inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.3, qe jane te paangazhuar ne kontrata te tjera, eshte deklarim i rreme, per sa kohe ata jane te puensuar ne subjekte te tjera apo organe shterore sipas konstatimit te mesiperm.

Neni 45, pika e, i ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” percakton ”Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë” e) **është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t’i japë këto**

informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre. Ndërsa neni 47, përcakton: Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës. Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.

## **2. Operatori ekonomik : “ALMO” konstruksion shpk, nuk kualifikohet per arsyet e meposhtme**

I. Ne kundërshtim me kriterin e dhënë në pikën 2.3.1, ky operator nuk plotëson asnjërin nga pikat e kërkuara “Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën” :

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga anëtarët e cilës ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se **dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

II. Nga ky operator ekonomik nuk është përmbushur kriteri i përcaktuar në pikën: 2.3.3 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet. Operatori/et ekonomike për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të vërtetojë se ka në licencën e shoqërisë si drejtues teknik për kryerjen e punimeve në këtë objekt, minimalisht:

Inxhinier Ndertimi	2 (dy)
Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
Inxhinier Gjeodet	1 (nje)
Inxhinier Mekanik	1 (nje)
Inxhinier Elektrik	1 (nje)
Inxhinier Mjedisi	1 (nje)
Inxhinier Gjeolog	1 (nje)

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin teknik të punësuar dhe Inxhinieret e mëposhtme:  
1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik

## **3.Operatori ekonomik “Meteo” shpk, nuk kualifikohet per arsyet e meposhtme**

I. Ne kundërshtim me kriterin e dhënë në pikën 2.3.1, ky operator nuk plotëson asnjërin nga pikat e kërkuara “Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën” :

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga anëtarët e cilës ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ose

**b.** Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se **dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

II. Ne kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit nuk ka plotësuar kapacitetet teknike për kapacitetin «Fabrikë Asfaltbetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore (me largësi jo më shumë se 70 Km), copë, 1, në pronësi / me qera / kontrate furnizimi».

III. Ne kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit, nuk rezulton të ketë në stafin teknik të punësuar dhe 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik.

Me datë 28.04.2021 nga anëtarët e KVO perfundoj vlersimi i ofertës të paraqitura nga op. ek. pjesëmarrës në tender me këtë **renditje perfundimtare** :

1. Te pranojë ofertën e paraqitur nga op.ekonomik **“JUBICA”sh.p.k** numri i NIPT-it K26529001I me oferte, me vlerë **80,000,025** (Tetëdhjetë milion e njëzet e pesë ) leke pa tvsh, shpallet fitues si oferta me vlerë më të vogël pasi i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara në DST dhe kualifikohet dhe shpallet fitues si oferta më e vogël.

2. Te pranojë ofertën e paraqitur nga op.ekonomik **“STERKAJ”sh.p.k** numri i NIPT-it J68310708M me oferte, me vlerë **80,143,357** (Tetëdhjetë milion e njëqindë e dyzet e tremijë e treqindë e pesëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara në DST dhe kualifikohet

#### **Refuzuar :**

1. B.O Ekonomik **“KAEXH”sh.p.k & “ULZA”sh.p.k** me oferte me vlerë **72,118,894** (Shtatëdhjetë e dy milion e tetëqindë e njëqindë e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqindë e nëntëdhjetë e katër ) leke pa tvsh

2. Op.ekonomik **“ALMO KONSTRUKSION ”sh.p.k** me oferte, me vlerë 80,433,458 (Tetëdhjetë milion e katërqindë e tridhjetë e tremijë e katërqindë e pesëdhjetë e tetë) leke pa tvsh

3. Op.ekonomik **“METEO”sh.p.k** me oferte me vlerë **80,670,651.6** ( Tetëdhjetë milion e gjashtëqindë e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqindë e pesëdhjetë e një pike gjashtë)leke pa tvsh

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“JUBICA”sh.p.k** me adresë . Shkoder, SHKODERT rruga Luigj Gurakuqi ,Kuklejt nr.108 Perfaqësues z.Ndoc Kulla se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme **80,000,025** (Tetëdhjetë milion e njëzet e pesë ) leke pa tvsh shpallet fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [**Bashkia e Pukës, Sheshi Terbuni, Nr.1, Pukë**] sigurimin e kontratës dhe dokumentacionin, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/**publikimit të këtij njoftimi.**

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [**vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra**], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **28.04.2021**

Ankesa: **Ska patur**

\* \* \*

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

**Gjon GJONAJ**